




DEICHMANN

DEICHMANN

Kodi i sjelljes



Kodi i sjelljes së DEICHMANN-it përfshin Kodin e Sjelljes BSCI, versionin 1/2014. Grupi DEICHMANN e pranon Kodin e Sjelljes BSCI dhe ka përdorur parashtimin e tij për të kontribuar më mirë në kaskadën e BSCI-së.

Hyrja

Ne, Grupi DEICHMANN, jemi angazhuar që të jemi të përgjegjshëm për pranueshmërinë sociale dhe kujdesin ndaj mjedisit të operacioneve tona globale. Për t'ju shpjeguar pozicionin tonë partnerëve tanë të biznesit dhe gjithë kompanive përgjatë zinxhirit tonë të furnizimit, personelit tonë dhe palëve të tjera, ne kemi hartuar Kodin e Sjelljes të DEICHMANN-it (Versioni 2016). Për ne, është një kërkesë e padiskutueshme që të gjithë partnerët e biznesit dhe kompanitë përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it ta zbatojnë pa përjashtim këtë Kod të Sjelljes.

Ky Kod i Sjelljes i DEICHMANN-it, ndjek parimet më të fundit të Nismës për Pajtueshmërinë e Biznesit Social (NPBS) dhe është bazuar mbi marrëveshjet ndërkombëtare të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Udhëzimet e të Drejtave për Fëmijëve dhe Parimet e Biznesit, Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, Parimet Udhëzuese të OECD-së, Marrëveshjen Globale të Kombeve të Bashkuara si dhe konventat dhe rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës që janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të punës përgjatë zinxhirit të furnizimit.

Me këtë Kod Sjelljeje të DEICHMANN-it, ne synojmë të prezantojmë dhe të zhvillojmë më tej parimet tona në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e biznesit të DEICHMANN-it dhe gjithë palëve përgjatë zinxhirit të furnizimit. Në rast moszbatimi, ne do ta ndërpresim marrëdhënien e biznesit.

Rregulli ynë bazë është që partnerët e biznesit të DEICHMANN-it dhe kompanitë përgjatë zinxhirit të furnizimit (nën-kontraktorët) duhet të ndjekin parimet e përcaktuara në këtë dokument në çdo gjë që bëjnë. Nëse një nga parimet tona përcakton më pak se ligjet e një shteti apo rajoni, në këtë rast do të zbatohen ligjet kombëtare d.m.th. standardet më të larta. Në rast të tillë, partnerët e biznesit të DEICHMANN-it duhet të njoftojmë menjëherë Grupin DEICHMANN. Çdo dispozitë ose rregull që kalon përtej ligjit dhe që vendos në mënyrë të tillë standarde më të larta, nuk konsiderohet i pavlefshëm por duhet të zbatohet.



Heinrich O. Deichmann, Kryetar i bordit të drejtuesve dhe drejtorëve ekzekutivë

Një "partner biznesi i DEICHMANN-it" është një partner kontraktual që është përgjegjës për një produkt, proces ose shërbim dhe që, për shkak të pozicionit të tij në zinxhirin e furnizimit, mund të sigurojë që të plotësohen standardet sociale. Ky përcaktim mund të zbatohet për prodhuesit, shpërndarësit, importuesit, montuesit, ofruesit e shërbimit, etj.

Një "nën-kontraktor" është një entitet ekonomik përgjatë zinxhirit të furnizimit, direkt ose tërthor, që i ofron furnizuesit mallra dhe/ose shërbime që furnizuesi përdor në dhe/ose për prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve dhe që janë thelbësore në atë kontekst.

1. Pjesëmarrja dhe mbrojtja e personelit

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të përcaktojnë praktika të provuara të menaxhimit për ta lejuar personelin dhe përfaqësuesit e tyre të marrin pjesë në shkëmbimin e informacionit përkatës rreth çështjeve që kanë lidhje me punën. Ata duhet të lejojnë masa të përshtatshme për të mbrojtur personelin në pajtim me objektivat e Kodit të sjelljes së DEICHMANN-it dhe të ndërmarrin hapa specifikë për ta informuar personelin rreth të drejtave dhe detyrave të tyre.

Për më tepër, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it zotohen të zhvillojnë aftësitë ndërmjet shefave, personelit dhe përfaqësuesve të tyre të personelit deri në masën që këto praktika të mund të nguliten me sukses në operacionet e tyre të biznesit. Kjo kërkon trajnim të vazhdueshëm dhe trajnim të avancuar në të gjitha nivelet operacionale, për sa i përket sigurisë industriale në veçanti.

Në bizneset individuale, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit duhet të përcaktojnë ose marrin pjesë në mekanizmat e efekshme të ankesave për individët dhe grupet që mund të jenë ndikuar negativisht. Edhe kur ekzistojnë sisteme ligjore të efektshme dhe efikase, mekanizmat e ankesave mund të jenë me përfitim të veçantë, p.sh. duke ofruar akses të shpejtë të një personi i besueshëm, një ndreqje të menjëhershme të çdo ankesë, kosto të reduktuara dhe një qasje ndërkombëtare.

2. Puna e fëmijëve dhe mbrojtja dhe të rinjve

Puna e fëmijëve është çdo punë që bëhet nga

njerëz më të rinj se 15 vjeç, përveçse kur ligjet vendore përcaktojnë një moshë minimale më të lartë ose frekuentimin për një kohë më të gjatë të arsimit të detyruar, e në rast të tillë do të zbatohet mosha më e madhe. Megjithatë, nëse, mosha minimale ligjore është 14 vjeç sikurse është përcaktuar në përjashtimet që kanë lidhje me shtetet në zhvillim në Konventën e ILO-së 138, do të zbatohet mosha më e ulët.

“Të punësuarit adoleshentë” janë personeli që është më i madh se një fëmijë brenda kuptimit të mësipërm dhe më të rinj se 18 vjeç.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet të përdorin ose tolerojnë kurrë direkt ose tërthor punën e fëmijëve brenda kuptimit të mësipërm. Ata zotohen të shikojnë mekanizmat e duhura për përcaktimin e moshës në procesin e punësimit që nuk duhet kurrë të poshtërojë ose përulë punonjësit.

Në rastet kur fëmijët kanë rënë viktimë të punës së fëmijëve brenda kuptimit të mësipërm dhe janë çliruar prej saj, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të vendosin, dokumentojnë dhe t'i kujtojnë personelit të tyre dhe palëve të tjera të interesuara metodat dhe procedurat për sigurinë, arsimin dhe zhvillimin e fëmijëve.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet t'i mbështesin këta fëmijë për t'i lejuar të ndjekin shkollën derisa sa të mos jenë më fëmijë brenda kuptimit të mësipërm.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-

it duhet të vendosin, dokumentojnë dhe t'i kujtojnë personelit të tyre dhe palëve të tjera të interesuara metodat dhe procedurat që promovojnë arsimimin e fëmijëve të mbuluar nga Rekomandimi 146 i ILO-së që janë subjekt i ligjeve vendore për ndjekjen e detyruar të shkollës ose të cilët ndjekin shkollën. Këto përfshijnë masa që garantojnë që asnjë fëmijë ose punonjës adoleshent të mos jetë punësuar gjatë orarit të shkollës dhe që numri i orëve në ditë që harxhohet për të udhëzuar (nga dhe për në punë, shkollë dhe shtëpi), ndjekja e shkollës dhe puna të mos i kalojë 10 orë.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurojnë që punonjësit adoleshentë të mos punojnë gjatë natës dhe që jashtë vendit të tyre të punës ata të jenë të mbrojtur ndaj kushteve që e vendosin shëndetin, sigurinë, moralin dhe zhvillimin e tyre emocional dhe fizik në rrezik. Kompanitë do t'i ofrojnë punonjësve adoleshentë akses te mekanizma të efektshme ankimi, sisteme shkollimi dhe programe të sigurisë të industrisë.

3. Puna e detyruar

Puna e detyruar është çdo punë ose shërbim i kërkuar nga një person nën kërcënimin e ndëshkimit dhe për të cilin ky person nuk ka dalë vullnetar.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet të përdorin kurrë ose të tolerojnë punën e detyruar ose punën e detyrueshme përfshi punën me marrëveshje, robërinë, trafikimin e qenieve njerëzore ose punën në burg.

Nëse ata përfitojnë nga forma të tilla të punës përdorur nga partnerët e tyre përgjatë zinxhirit të furnizimit, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it mund të rrezikohen që të akuzohen për bashkëfajësi.

Gjatë punësimit, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet t'i kërkojnë njerëzve një depozitë ose të dorëzojnë dokumente personale. Personeli ka të drejtën të largohet nga puna pa pengesa në çdo kohë dhe ta ndërpresë kontratën e punësimit duke dhënë njoftimin në një periudhë të arsyeshme.

4. Veprimet disiplinuese

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që personeli të mos ekspozohet ndaj trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, ngacmimeve seksuale, ndëshkimeve fizike, shtrëngimit emocional ose fizik dhe/ose abuzimit me gojë.

Çdo veprim disiplinor i nevojshëm duhet që gjithnjë të parashtrohet me shkrim dhe t'i shpjegohet me gojë personelit me fjalë që kuptohen qartë.

5. Diskriminimi

Në veçanti në lidhje me punësimin e saj po të tij, trajnimin e mëtejshëm, rritjen në detyrë, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose daljes në pension, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet të diskriminojnë ndaj një personi për shkak të

racës, kastës, lindjes, klasës sociale, etnisë, kombësisë, fesë, invaliditetit, orientimit seksual, anëtarësimit në një shoqatë, përkatësive politike, detyrimeve familjare apo të gjinisë ose t'i tolerojë këto diskriminime.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk do ta pengojnë personelin e tyre të ushtrojë të drejtat për të ndjekur mësimet ose sjelljet apo përmbushur nevojat në lidhje me racën, klasën sociale, kombësinë, fenë, invaliditetin, gjininë, orientimin seksual, anëtarësimin në një shoqatë ose përkatësinë politike.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet të tolerojnë kurrë asnjë sjellje përfshi gjestet, shprehjet me gojë ose kontaktet fizike që lënë të kuptojnë sulme seksuale, një kërcënim, abuzim ose shfrytëzim.

Personeli femër ka të paktën të drejtën e mbrojtjes ligjore para dhe pas shtatzënisë. Personeli femër nuk duhet të pushohet nga puna për shkak të shtatzënisë së tyre. Gratë shtatzëna nuk duhen detyruar të punojnë në vende pune ku rrezikohet shëndeti i tyre.

6. Punësim pa rrezik

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që kushtet e punësimit të tyre të mos çojnë në pasiguri ose rrezik social ose ekonomik për personelin e tyre. Ata do të sigurohen që e gjithë puna të bëhet mbi baza të kontratave të njohura dhe dokumentuara të punësimit që janë në pajtim me ligjet dhe rregullat, praktikat, traditat kombëtare dhe

standardet ndërkombëtare të punës, cilado të ofrojnë mbrojtjen më të madhe.

Përpara fillimit të punësimit, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet t'i japin personelit informacion gjithëpërfshirës rreth të drejtave, detyrave dhe kushteve të tyre të punës përfshi orarin e punës, shpërblimin, të drejtat e pushimit, mbrojtjen e shtatzënisë dhe kushtet e pagesës.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të ofrojnë kushte njerëzore të punës. Kjo përfshin mbështetjen e personelit të tyre në rolin e tyre si prindër ose kujdestarë, veçanërisht në lidhje me punonjësit migrantë dhe punonjësit sezonalë, fëmijët e të cilëve mund të jenë lënë në vendin nga i cili vijnë migrantët.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet ta përdorin marrëdhënien e punësimit në mënyrë të tillë që të jetë qëllimisht në kundërshtim me qëllimin aktual të ligjit. Kjo përfshin, por nuk është e kufizuar në, (a) programet e trajnimit që nuk kanë objektivë ofrimin e kualifikimeve ose punës së rregullt, (b) punën sezonale ose punët e rastit nëse përdoren për të nënvlehtësuar mbrojtjen e personelit, dhe (c) kontratat vetëm për punë. Përveç kësaj, nën-kontraktimi nuk duhet të nënvlehtësojë asnjë nga të drejtat e personelit.

7. Shpërblimi i përshtatshëm

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të sigurohen që pagat dhe pagesat e

paguarapërnjëjavëstandardepunetëplotësojnë të paktën kërkesat ligjore, ose nëse janë më të larta, të jenë pajtim me standardet e industrisë të përcaktuara në marrëveshjet kolektive të negocimit dhe të përfshijnë përfitimet sociale ligjore. Pagat dhe pagesat e paguara duhet të jenë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë të personelit, për të lejuar që personeli dhe familjet e tyre të jetojnë një jetë të mirë dhe të kenë disa të ardhura të disponueshme.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që përbërja e saktë e pagave, pagesave dhepërfitimevetëbëhettransparente rregullisht. Uljet lejohen nëse përcaktohet nga ligji ose marrëveshjet kolektive të negocimit. Uljet për arsye disiplinimi nuk lejohen. Niveli i shpërblimit duhet të reflektojë kualifikimet dhe nivelin e arsimit të personelit dhe të t'i referohet orarit të rregullt të punës.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që pagat dhe përfitimet të paguhen rregullisht në pajtim të plotë me të gjitha ligjet në fuqi, në mënyrë të ligjshme dhe të favorshme për personelin. ILO-ja lejon pranimin e pagesave të pjesshme në natyrë.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që të mos ketë nën-kontraktim të personelit dhe stazh pune të rremë që synon të anashkalojë detyrimet e tyre ndaj personelit në pajtim me ligjet industriale e të sigurimit social dhe rregullave të tjera.

8. Orar i arsyeshëm pune

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët

përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të pajtohen me ligjet e zbatueshme dhe standardet industriale që kanë të bëjnë me orët e punës. Në asnjë lloj rrethane nuk mund t'i kërkohet personelit të punojë rregullisht për më gjatë se 48 orë në javë. Duhet lejuar të paktën një ditë pushimi në javë. Megjithatë, Grupi DEICHMANN i pranon përjashtimet e ILO-së. Ligjet dhe rregulloret kombëtare në fuqi, standardet e krahasueshme industriale ose marrëveshjet kolektive të negocimit duhet të interpretohen brenda kushteve ndërkombëtare bazë të përcaktuara nga ILO-ja.

Në përjashtimet e përcaktuara nga ILO-ja, kufiri më i lartë për numrin më të lartë të orëve të punës mund të kalohet, por në rast të tillë lejohet mbikoha mbi baza vullnetare. Nëse mbikoha (orët që e kalojnë orarin e rregullt lavor) është rënë dakord me personelin e partnerëve të biznesit ose nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it, duhet siguruar që ata të paguhen gjithnjë me një normë më të lartë por jo më pak se një herë e një çerek të tarifës normale. Mbikoha duhet të jetë përjashtim dhe duhet që gjithnjë të bëhet me dëshirë.

9. Liria e anëtarësimit dhe negocionit kolektiv

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it respektojnë të drejtën e të gjithë personelit të formojë shoqata të punonjësve sipas dëshirës së tyre të lirë, të anëtarësohen dhe të angazhohen në negociata kolektive.

Në situata në të cilat liria e anëtarësimit dhe e drejta për negocim kolektiv kufizohet nga

ligji, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet t'i ofrojnë personelit të tyre mënyra të krahasueshme për t'u anëtarësuar lirisht dhe në mënyrë të pavarur për të diskutuar çështjet e punës me punëdhënësin.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk do të diskriminojnë ndaj personelit për shkak të anëtarësimit të tyre në sindikata ose nuk do ta pengojnë aksesin e përfaqësuesve të tyre të personeli në vendin e tyre të punës ose që të ndërveprojnë me ta.

10. Shëndeti dhe siguria

Bazuar në supozimin se partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit e njohin sektorin dhe çdo rrezik të veçantë më mirë se kushdo, ata duhet të ofrojnë një mjedis jetese dhe pune të sigurt, të pastër dhe të shëndetshëm. Ata duhet të caktojnë një përfaqësues të menaxhimit që më pas do të jetë përgjegjës për të gjithë shëndetin dhe sigurinë e personelit dhe për pajtueshmërinë e plotë të pjesëve të shëndetit dhe sigurisë së këtij Kodi të sjelljes.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të marrin masa që të parandalojnë aksidentet industriale ose efektet negative mbi shëndetin e personelit gjatë punës ose që dalin nga puna e tyre ose që janë të lidhura në çdo lloj mënyre me punën duke minimizuar shkaqet e rrezikut në mjedisin e punës. Individët që kanë nevojë për mbrojtje, të tillë si, por jo të kufizuara te, punonjësit adoleshentë, nënat e reja dhe gratë shtatzënë dhe personat me aftësi të kufizuara do të marrin mbrojtje të veçantë.

Zbatimi i sistemeve që garanton një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm kërkon bashkëpunim aktiv ndërmjet menaxhimit dhe personelit dhe/ose përfaqësuesve të tyre. Një formë e tillë bashkëpunimi janë komitetet e sigurisë industriale. Kompanitë do të sigurojnë që të krijohen sistemet për të përcaktuar, vlerësuar, parandaluar dhe luftuar rreziqet e mundshme ndaj shëndetit dhe sigurisë së punonjësve. Ata do të marrin masa të efektshme për të parandaluar aksidentet, lëndimet dhe sëmundjet e mundshme të personeli gjatë ose në lidhje me punën e tyre duke minimizuar rreziqet në mjedisin e punës. Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të sigurojnë që personeli të marrë një trajnim të përshtatshëm dhe dokumentuar për shëndetin dhe sigurinë dhe që ky trajnim të përsëritet për të gjithë personelin e ri ose të ripunësuar.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të bëjnë çdo përpjekje për të përmirësuar mbrojtjen e personelit në rast aksidentesh, për shembull nëpërmjet sistemeve të detyrueshme të siguracionit. Brenda sferës së tyre të influencës, ata do të marrin të gjitha masat e duhura për t'i bërë implantet dhe ndërtesat e përdorura nga ata, përfshi vendet ku punon e jeton personeli, nëse ka të tilla të ofruara nga punëdhënësi, të qëndrueshme dhe të sigurta dhe të parandalojnë çdo emergjencë të parashikueshme.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të respektojnë të drejtat e personelit për t'u larguar nga ambientet e kompanisë pa pasur nevojë të kërkojnë leje, nëse kjo gjë është e nevojshme për t'u larguar menjëherë nga rreziku.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të ofrojnë një nivel të përshtatshëm të kujdesit mjekësor industrial dhe ambientet përkatëse.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të sigurojnë akses tek uji i pijshëm, vendet e sigurta dhe të pastra për të ngrënë dhe vendet e sigurta dhe të pastra për të përgatitur dhe ruajtur ushqimet. Ata do t'i ofrojnë të gjithë personelit të tyre gjatë gjithë kohës pajisje personale mbrojtëse (PPM) falas dhe të efektshme.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të sigurohen që fjetoret, nëse do të ketë për personelin, banjat dhe vendet për t'u larë të jenë të pastra dhe të sigurta dhe të plotësojnë kërkesat bazë.

11. Mbrojtja e mjedisit

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të kontrollojnë operimet e tyre për çdo ndikim mjedisor që mund të kenë dhe të përcaktojnë udhëzimet dhe proceset e efektshme që reflektojnë përgjegjësinë e tyre për mjedisin. Ata duhet të sigurohen që burimet natyrore të përdoren në mënyrë sa më të efektshme që të jetë e mundur. Çdo ligj dhe rregullore e zbatueshme që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit në shtetin në të cilin ata punojnë duhet të zbatohet.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-

it do të sigurojnë zbatimin e masave të përshtatshme që reduktojnë ndikimin negativ mbi komunitetin, burimet njerëzore dhe mjedisin si një i tërë. Sa herë që të jetë e mundur, substancat e rrezikshme duhet të shmangen ose të përdoren vetëm në një masë shumë të kufizuar. Ato mund të përdoren vetëm nëse përdoren saktë dhe nëse ato nuk dëmtojnë mjedisin.

Hedhja që nuk dëmton mjedisin e mbeturinave dhe kontejnerëve duhet të garantohet dhe të provohet sipas kërkesës. Të gjitha mbeturinat gjatë prodhimit duhet të hidhen në mënyrën e duhur.

12. Biznesi etik

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it zotohen të mos angazhohen në asnjë lloj forme korrupsioni, zhvatjeje, përvetësimi ose mitmarrjeje përfshi, por jo të kufizuar në premtimin, ofrimin ose dhënien e një nxitjeje tjetër apo të papërshtatshme financiare.

Ne presim që partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it të kenë informacionin e saktë mbi aktivitetet, strukturën dhe performancën dhe t'i publikojnë ato në pajtim me rregulloret në zbatim dhe praktikatat industriale të krahasueshme.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk duhet të marrin pjesë në falsifikimin e këtyre informacioneve ose në asnjë lloj mashtrimi përgjatë zinxhirit të furnizimit. Ata po ashtu duhet të grumbullojnë, të përdorin

dhe të mbrojnë të dhënat personale (përfshi të dhënat që i përkasin personelit, partnerëve të biznesit, klientëve dhe konsumatorëve) me kujdes të arsyeshëm dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret e privatësisë dhe sigurisë së informacionit.

13. Sistemet e menaxhimit

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të marrin masa të qarta për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, t'i integrojnë ato në të gjitha proceset e biznesit dhe t'i bëjnë pjesë të pandashme të filozofisë dhe politikës së tyre të korporatës.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të caktojnë një menaxher që do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it brenda organizatës së tyre.

Bordet ekzekutive të partnerëve të biznesit dhe nën-kontraktorëve përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të kontrollojnë rregullisht zbatimin e standardeve të përcaktuara në Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it.

Bordet ekzekutive të partnerëve të biznesit dhe nën-kontraktorëve përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it do të jenë përgjegjës për përmbushjen e standardeve të përcaktuara në Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it në lidhje me të gjithë personelin nën mbikëqyrjen e tyre dhe do të bien dakord

- të caktojnë dikë në secilin vend pune që kanë në pronësi ose menaxhojnë

përgjegjësinë për zbatimin e Kodit të sjelljes së DEICHMANN-it;

- të sigurohen që i gjithë personeli ta njohë Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it duke ia kujtuar përmbajtjen atyre në një gjuhë të kuptueshme për personelin dhe nëpërmjet trajnimeve të rregullta mbi Kodin e sjelljes të DEICHMANN-it;
- të mos marrin masa disiplinore, të largojnë ose të diskriminojnë në një mënyrë tjetër personelin që jep informacion rreth pajtueshmërisë me Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të provojnë nëpërmjet dokumentacionit se ata i plotësojnë standardet e Kodit të sjelljes së DEICHMANN-it. Ata duhet të japin akses te dokumente të tilla dhe t'i japin informacionin e përshtatshëm palëve të komisionuara nga Grupi DEICHMANN për të kontrolluar nëse standardet janë plotësuar.

Partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it duhet të përfshijnë pajtueshmërinë me Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it në të gjitha marrëveshjet me nën-kontraktorët. Këto marrëveshje duhet të detyrojnë nën-kontraktorët për të plotësuar të gjitha standardet e përcaktuara në Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it (përfshi këtë klauzolë), për të marrë pjesë në kontrollet e furnitorëve.

14. Kontrollat dhe monitorimi

Për të kontrolluar pajtueshmërinë me Kodin e sjelljes së DEICHMANN-it, Grupi DEICHMANN do të përdorë edhe kontrollues të pavarur për

kontrollin social dhe mjedisor në emër të Grupit DEICHMANN. Partnerët e ndryshëm të biznesit të DEICHMANN-it do t'i nënshtrohen kushteve të ndryshme të zbatimit, të cilat varen nga roli i tyre në zinxhirin e furnizimit.

Ne, Grupi DEICHMANN, kemi të drejtën të monitorojmë pajtueshmërinë me Kodin e sjelljes nëpërmjet inspektimeve sistematike, të panjoftuara. Këto inspektime do të bëhen nga anëtarë të Grupit DEICHMANN ose kontrollorët e pavarur, në zbatim të udhëzimeve të Nismës së Pajtueshmërisë me Biznesin Sociale.

15. Veprimet ndreqëse dhe mopajtueshmëria

Kodi i sjelljes së DEICHMANN-it përcakton parimet që pritet të plotësojnë partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it.

Ne e dimë se disa nga këto pritshmëri nuk mund të plotësohen gjithnjë menjëherë nga të gjithë. Për Grupin DEICHMANN, është e rëndësishme që në rast të mospajtueshmërisë, partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar situatën dhe ndjekur këto parime në të ardhmen. Sa kohë lejohet kjo që të zgjasë varet nga lloji i veprimit ndreqës dhe masa e rrezikut dhe duhet rënë dakord me Grupin DEICHMANN.

Nëse ka shkelje të vazhdueshme të këtij Kodi dhe partnerët e biznesit dhe nën-kontraktorët përgjatë zinxhirit të furnizimit të DEICHMANN-it nuk marrin masa ndreqëse, ne do të jemi të detyruar që ta ndërpresim bashkëpunimin.

